



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

14-22/01-0280084/18 më 23-11-2018

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008), dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet Vendimi për subvencionimin e prindërve të cilët kanë të regjistruar fëmijët e tyre në çerdhet me bazë në komunitet, në komunën e Prishtinës.
- II. Subvencionimi i prindërve sipas pikës I të këtij vendimi do të bëhet në bazë të të ardhurave mujore neto si në vijim:
 1. Prindërit me të ardhura mujore neto deri në 500 €, subvencionohen 50 €;
 2. Prindërit me të ardhura mujore neto deri në 700 €, subvencionohen 30 €;
 3. Prindërit me të ardhura mujore neto deri në 1000 €, subvencionohen 20 €.
- III. Prindërit të cilët kanë të regjistruar biznese funksionale diskualifikohen nga subvencionohet si në pikën II.
- IV. Nëse prindërit nuk i raportojnë të dhënat e sakta mbi të hyrat, përjashtohen nga përfitimi i subvencionit në momentin e vërtetimit.
- V. Vlerësimi i kërkesave dhe vendimmarrja për subvencionim si në pikën II, do të bëhet nga një anëtar i caktuar nga komuna e Prishtinës dhe dy anëtarë të caktuar nga çerdhja.
- VI. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për Financa e komunës së Prishtinës.
- VII. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet vendimi i dt. 9 shkurt 2016.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Çerdheve me bazë në komunitet;
- Drejtorisë së Arsimit;
- Drejtorisë për Financa;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti

